




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASENIT UJOR SEMAN

VENDIM

Nr.16, datë 30.10.2024



**PËR**  
**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIM TË LEJES, NGA**  
**SUBJEKTI “SH.A UJËSJELLËS KANALIZIME FSHAT ELBASAN”**  
**TEK SUBJEKTI**  
**“SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME ELBASAN”.**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Seman,

**V E N D O S I:**

1. Miratimin e kërkesës për transferimin e lejes Nr.A 1, datë 5.5.2009 “Leje për përdorim të rezervës ujore e lidhje kontrate, për furnizim të popullatës me ujë të pijshëm, nga Sh.A.Ujesjelles Fshat Elbasan,

**Nga subjekti “SH.A Ujësjetllës Kanalizime Fshat Elbasan” tek subjekti “Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan” sh.p.k me Nipt M23322201V.**

2. Treguesit paraprakë janë si më poshtë

PEmërtimi i burimit	KOORDINATAT KRGJSH		Q
	X	Y	l/s
Pus shpimet në Shelg	497531.5	4533376.5	45
Pus shpimi në Dëshiran	496043.9	4526475.4	12
Burimi ujur në Kosovë	484622.5	4529439.9	17
Burimi ujur në Çërragë	484340.9	4531089.1	25



3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SEMAN**

**MBARIME ISUFAJ**

